



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI**

---

Numri i lëndës: 2023:264150

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05460938

CPP.nr.134/23

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit SH.A. K....me seli në Mitrovicë, kundër debitorit E.D nga Vushtrria rruga ..., duke vendosur sipas prapësimit të debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit të Përmbaruesit Privat Atip Mustafa në Vushtrri, P.nr.4631/20, të datës 27.11.2020, jashtë seance me datë 15.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. PRANOHET PJESËRISHT prapësimi i debitorit E.D, SHFUQIZOHET PJESËRISHT Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.4631/20, të datës 27.11.2020 dhe OBLIGOHET debitori E.D, që në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, kreditorit SH.A. K..., në emër të borxhit për shfrytëzimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, për periudhën prej 01.01.2019 deri 31.10.2020, t' ia paguaj shumën prej 194.13 Euro, me kamatë ligjore, vjetore prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së propozimit për përmbarim 27.11.2020, deri në pagesën definitive të borxhit.

II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesës së kreditorit në shumë prej 1,234.85 euro, për periudhën prej 01.05.2003 deri më 31.12.2018.

## A r s y e t i m

Kreditori SH.A. K... me seli në Mitrovicë, në bazë të dokumentit të besueshëm, “Faturës dhe Kartelës financiare të konsumatorit” me kod V3296 ka parashtruar propozim për përmbarrim pranë Përmbarruesit Privat Atip Mustafa në Vushtrri, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori E.D, me adresë në rr. ... komuna e Vushtrrisë, që në emër borxhit për shfrytëzimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit ta paguaj shumën prej 1,428.98 Euro me kamatë ligjore, vjetore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës.

Përmbarruesi Privat Atip Mustafa, më Urdhrin P.nr.4631/20, të datës 27.11.2020 e ka lejuar përmbarrimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori E.D me datë 26.07.2023, ka paraqitur propozim për kthim në gjendjen e mëparshme për shkak të lëshimit të afatit për paraqitjen e prapësimit. Gjykata me aktvendimin CPP.nr.112/23 të datës 16.10.2023 ka aprovuar propozimin e debitorit, ashtu që, ka lejuar debitorin që në afat prej 7 ditësh ta ushtroj prapësimin.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim kundër urdhrin për lejimin e përmbarrimit të përmbarruesit privat duke e kundërshtuar urdhrin e përmbarruesit privat me pretendimin, se i njëjti është i pabazuar, i paargumentuar, në të njëjtin nuk është cekur periudha për të cilën kërkohet borxhi dhe se borxhi është parashkruar konform nenit 360 të LMD-së, duke i propozuar gjykatës qa prapësimin ta pranoj si të bazuar.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim duke pretenduar propozimi për përmbarrim është në harmoni me nenin 29 të LPP-së, se borxhi i krijuar nuk është parashkruar sepse debitori ka pranuar shërbimet, dhe se këtu kemi të bëjmë më Përtëritje të Borxhit (Novacion),dhe i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata me anë të konkluzionit CPP.nr.134/23 të datës 22.02.2024 ka kërkuar nga kreditori që në afat prej 3 ditësh ta precizoj propozimin për përmbarrim në atë mënyrë që të precizoj periudhën për të cilën e kërkon borxhin dhe gjykatës t’ia dërgoj ekstraktin e verifikuar nga librat afariste në origjinal apo në kopje të vërtetuar. Kreditori, brenda afatit të përcaktuar nga gjykata ka bërë precizimin e periudhës dhe gjykatës ia ka dërguar ekstraktin e verifikuar nga librat afariste në origjinal.

Gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar për faktin se borxhi i krijuar për debitorin për periudhën prej 01.05.2003 deri më 31.12.2018 në shumë prej 1,234.85 euro, është borxh i parashkruar konform nenit 360, par.1, nën par. 1.1 të Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve ku parashihet “*Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake*”, ndërsa sa i përket rrjedhjes së afatit të parashkrimit, në nenin 360, par.2 të të njëjtit ligj parashihet “*Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë*”.

Tutje, gjykata vlerëson se në rastin konkret, edhe pse debitori ka kryer pagesa të kohëpaskohshme, nuk ka bërë pranimin e borxhin, për faktin se neni 368 par.1 parasheh “*Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin.*” ndërsa par.2 i po të njëjtit nen parasheh “*Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit.*” e që sipas gjykatës, pagesat e kohëpaskohshme, paushalle, në formë të kësteve, pa specifikuar se për cilin muaj të shpenzimit të ujit kanë të bëjnë, nuk shkaktojnë ndërprerjen e parashkrimit, kjo për faktin se pagesa e borxhit në formë të kësteve mund të vijë në shprehje vetëm pas një marrëveshje (kontrate) për pagesën (ri programimin) e borxhit ndërmjet kreditorit dhe debitorit, e që në rastin konkret, në shkresat e lëndës nuk ka prova se një marrëveshje (kontratë) e tillë ekziston ndërmjet palëve, se kreditori ka ndërmarrë veprime ligjore ndaj debitorit, dhe nuk ka asnjë provë tjetër e cila do të mund të konsiderohej si pranim i borxhit nga ana e debitorit.

Për më tepër edhe Gjykata Supreme përmes aktgjykimit Rev.nr.148/2012 të datës 09.09.2013 (faqe 3, paragrafi 4) ka mbajtur qëndrimin se pagesat paushalle, të kohëpaskohshme, për të cilat nuk është specifikuar asnjëherë se për cilin muaj të shpenzimit të energjisë elektrike kanë të bëjnë, nuk shkaktojnë ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit,

Gjykata gjeti se debitori për periudhën 01.01.2019 deri me 31.10.2020 ka krijuar detyrime në shumën prej 396.13 Euro, ndërsa brenda periudhës së njëjtë ka kryer pagesa në shumën prej 202.00 Euro, ndërsa ka mbetur pa paguar borxhin në shumë prej 194.13, e i cili është i bazuar dhe se nuk është parashkruar duke pasur parasysh dispozitën e nenit 360.2 të Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve me të cilën parashihet që afati i parashkrimit për çdo kërkesë të arritur gjatë një viti, fillon të rrjedhë në fundin e atij viti, e që në rastin konkret, për të gjitha

kërkesat e arritura gjatë vitit 2019, afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë nga 01.01.2020, dhe për të gjitha kërkesat e arritura gjatë vitit 2020, afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë nga 01.01.2021, ndërsa në rastin konkret, kreditori me paraqitjen e propozimit për përmbarim me datën 27.11.2020 ka ndërprerë rrjedhjen e afatit të parashkrimit për kërkesat e arritura gjatë vitit 2019 dhe 2020.

Gjykata, sa i përket pretendimit të kreditorit të paraqitur në përgjigjen në prapësim, se në rastin konkret ka përtëritje të borxhit (Novacion), të njëjtin gjykata e refuzoi si të pabazuar sepse kreditori nuk ka paraqitur asnjë provë me të cilën do të vërtetohej se në rastin konkret kemi të bëjmë me përtëritje të borxhit. Po ashtu, sa i përket pretendimit tjetër të kreditorit se në rastin konkret debitori ka pranuar faturat dhe shërbimet dhe ka ndërprerë afatin e parashkrimit, gjykata, edhe këtë pretendim e refuzoi si të pabazuar konform Nenit 360 par.3 të Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve ku parashihet *”Parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë”*.

Gjykata, lidhur me kamatën ligjore, iu referua nenit 382,par.1 dhe 2 te Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Gjykata, ndërsa sa i përket afatit të rrjedhjes se kamatëvonesës i referohet mendimit juridik te Gjykatës Supreme te Kosovës nr. 265/20, dt. 01.12.2020, respektivisht par. II, III dhe VI te këtij mendimi. dhe gjeti se debitori ka rënë në vonesë në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit nga data kur është ushtruar propozimi për përmbarim e tutje.

Gjykata, bazuar në nenin 43.4, në lidhje me nenin 71 dhe 73 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

CPP.nr.134/23, me datë 15.03.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta e ankesës në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.